



**Konfederata
Ndërkombëtare e
Mamive**

Fuqizimi i punës së mamive në rrafsh global

Kompetencat themelore

mbi praktikën e mamive

Përditësuar-2018

Përmbajtja

1. HYRJE
2. PROCESI I RISHQYRTIMIT
3. STRUKTURA E KOMPETENCAVE
4. STRUKTURA E KORNIZËS SË KOMPETENCAVE
5. PËRMBAJTJA E KOMPETENCAVE
6. TERMINOLOGJI PRAKTIKE
7. KOMPETENCAT DHE TREGUESIT E AVANCUAR E OPSIONALË NË KONTEKSTE SPECIFIKE
8. KOMPETENCAT E PËRGJITHSHME

13. PARASHTATZANIA DHE PARALINDJA
17. KUJDESI GJATË, PARA DHE PAS LINDJES
19. KUJDESI I VAZHDUESHEM PËR GRUAN DHE TË PORSALINDURIN

Hyrje

Si presidente e Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, falë bashkëpunimit me Konfederatën Ndërkombëtare të Mamive (ICM) dhe Konfederatën Ndërkombëtare të Infermierëve, kam kënaqësinë të ndaj me Ju publikimin e Kompetencave themelore mbi praktikën e mamive.

Korniza e Kompetencave Themelore mbi praktikën e mamive, përgatitur nga Konfederata Ndërkombëtare e Mamive (KNM) përbëhet nga një paketë njohurish minimale mbi aftësitë dhe sjelljet profesionale të domosdoshme të një individi, i cili aspiron të ushtrojë profesionin e mamisë.

Kompetencat janë konfiguruar në katër kategori, të cilat duke u konsideruar si themelore në profesionin e mamisë, “përfaqësojnë aftësitë e domosdoshme të formimit të mamisë të re, në mënyrë që të arrihen rezultatet e pritshme të punës së saj.” Përkufizimet e kompetencave “lidhen me dokumentat udhëzuese autoritare të praktikës klinike të përdorura nga OBSH, dokumentet themelore të KNM si dhe me Deklaratat e Pozicionimit”.

Kompetencat e paraqitura në këtë dokument janë përditësuar përmes një procesi rishikimi. Përditësimi i Dokumentave Udhëzuese është i mbështetur në kërkime të vazhdueshme. Kjo paketë themelore Kompetencash gjithashtu është vlerësuar dhe amenduar si një paketë udhëzuese e përshtatshme jo vetëm për praktikën e mamive, por edhe për shëndetin seksual e maternal të të porsalindurit.

1 ICM International Definition of the Midwife, updated June 2017, available for download on ICM Eëbsite.

2 Butler et al. (2017). *Update of the International Confederation of Midwives' Essential Competencies for Basic Midwifery Practice. Draft Final Report.* April 24, 2017, p. 2. (internal ICM document).

3 Ibid

4 Available on the ICM eëbsite.

Procesi i rishqyrtimit

Kompetencat themelore të KNM-së për praktikën e mamive u paraqitën për herë të parë në vitin 2002 dhe u përditësuan në 2010-ën dhe në 2013-ën. Midis viteve 2014-2017, kjo paketë u rivlerësua nga një ekip studiuesish pranë **University of British Columbia**, të cilët përditësuan të dhënat e ardhura nga studimi kërkimor mbi punën e një grupi trajnuesish të mamive dhe *task forcës* së grupeve të interesit.

Procesi kërkimor përfshinte rishikimin e literaturës, analizën tematike të dokumenteve që lidheshin me kompetencat e mamive dhe politikave përkatëse. Gjithashtu ai realizoi një qasje të modifikuar *Delfi* që përfshinte tre runde të një studimi mbështetur në vëzhgimin *on-line* si dhe përpiloi një platformë konceptuale për paraqitjen e kompetencave.

5 Michelle Butler (Lead), Judith Fullerton (Consultant), Cheryl Aman (Research Coordinator), Karen Gelb (Research Manager, Midwifery Program UBC), Melanie Dowler (UBC Worklearn Student, Midwifery student).

6 Michelle Butler, Judith Fullerton, Mary Barger, Carol Nelson, Camilla Schneck, Marianne Nieuwenhuijze, Rita Borg-Xuereb (ICM Board Member), Rafat Jan (ICM Board Member), Atf Gherissi, Lorena Binfa, Mizuki Takegata, Caroline Homer.

7 Jim Campbell (Director and Executive Director of the Global Health Workforce Alliance), Fran McConville (ÉHO – Maternal & Child Health Committee), Gloria Metcalfe (Jhpiego MNH consultant), Gerard Visser (Chair FIGO Safe Motherhood Committee), Petra ten Hoop-Bender (UNFPA), Sarah Williams (Save the Children), Joeri Vermeulen (Secretary European Midwifery Association), Kimberley Pekin (NARM & MANA), Joy Lawn (Paediatrician) / Sarah Moxon (Neonatal Nurse)

Vëzhgimi virtual me tre runde *Delfi* është përgatitur në frëngjisht, anglisht dhe spanjisht. Ai përmban një model gjithpërfshirës të vlefshëm për protagonistët e jashtëm, për të zgjedhurit prej shoqatave anëtare të KNM-së (të të gjitha rajoneve dhe grupeve gjuhësore të KNM-së, si dhe prej vendeve me të ardhura të larta, të mesme dhe të ulta), për trajnuesit e mamive, moderatorët e tyre, Komitetet e KNM-së, bordin e KNM-së dhe për grupet e interesit.

Bordi i KNM-së, mbi draftin e raportit përfundimtar, përditësoi strukturën dhe përmbajtjen e kompetencave duke reflektuar në to propozimet e sugjeruara nga ekipi kërkimor në prill të vitit 2017. Anëtarët e Këshillit kërkuan që formati përfundimtar i kompetencave të ishte i thjeshtë, lehtësisht i arritshëm, i përdorshëm dhe i matshëm nga audiencia të shumfshita. Formatin dhe strukturën e Kompetencave, e rishikuar nga dy prej këshilltarëve: një specialist i web-it dhe një ekspert i formimit të mamive, u dizajnua vizualisht nga ekipi i profesionistëve të **Laerdal Global Health**.

8 Carolyn Levy, Blank Design and Project Management, Vancouver, Canada

9 Karyn Kaufman, retired Professor and Head of Midwifery, McMaster University, Hamilton, Canada

Strukturimi i kompetencave

Kompetencat u organizuan në katër kategori si më poshtë:



1. KOMPETENCAT E PËRGJITHSHME

Në këtë kategori Kompetencat kanë në vëmendje:

- maminë si anëtare e stafit të kujdesit shëndetsor;
- lidhjen midis gruas dhe personelit që kujdeset për të;
- aktivitetet që përfshijnë aspektet praktike të punës së maminë.

Kompetencat e përgjithshme përbëjnë bazën e domosdoshme në punën e përditshme të maminë. Këto kompetenca janë në themel të hartimit të çdo kurrikule dhe duhet të zotërohen nga trajnerët dhe moderatorët e mamive.

2. KOMPETENCAT SPECIFIKE PËR KUJDESIN PARA LINDJES DHE ATË ANTENATAL

Në këtë kategori kompetencat lidhen me:

- vlerësimin shëndetsor të gruas dhe të fetusit;
- promovimin e mirëqënies së tyre;
- zbulimin e komplikacioneve gjatë shtatzanisë;
- kujdesin për gruan me shtatzani të padëshiruar.

3. KOMPETENCAT SPECIFIKE PËR KUJDESIN GJATË SHTËRZIMEVE DHE GJATË LINDJES

Në këtë kategori kompetencat fokusojnë:

- vlerësimin dhe kujdesin për gruan para dhe gjatë lindjes;
- lehtësimin e proceseve fiziologjike për një lindje të sigurtë;
- kujdesin e menjëhershëm për të porsalindurin;
- zbulimin e komplikacioneve të mundshme të nëna ose fëmija.


4. KOMPETENCAT SPECIFIKE PER KUJDESIN E VAZHUESHËM PËR GRUAN DHE TË PORSALINDURIT

Kompetencat në këtë kategori adresojnë:

- vlerësimin shëndetsor të vazhdueshëm të nënës dhe fëmijës;
- edukimin shëndetsor të nënës;
- asistencën për ushqyerjen me gji të fëmijës;
- zbulimin e komplikacioneve;
- dhënien e shërbimit mbi planifikimin familiar.


Strukturimi konceptual i kornizës së kompetencave

Diagrami i mëposhtëm paraqet vizualisht strukturimin konceptual të kornizës së kompetencave



Shpjegimi i përbërësve të kompetencës

Grafiku paraqet përbërësit e kornizës së kompetencave



Emërtimi i kompetencës

Titulli i kompetences

Njohuritë

- ---
- ---
- ---
- ---
- ---
- ---

Aftësitë & sjelljet

- ---
- ---
- ---
- ---
- ---
- ---



Gjuha

Përshkrimi i Kompetencave dhe treguesve ka synuar qartësinë e gjuhës, matshmërinë e veprimeve të përshkuara si dhe saktësinë e përkthimit. Për të lehtësuar matjen e kompetencës/treguesve janë përdorur folje që përshkruajnë veprime konkrete.

Qartësia e përshkrimit të kompetencave dhe treguesve synon:

- të tregojë saktë lidhjen midis kompetencës dhe treguesit;
- nëpërmjet foljeve kalimtare që tregojnë konkretësi, të përshkruajë veprimet që i përshtaten nivelit të kërkuar, por që njëkohësisht mundësojnë matshmërinë;
- të përdorë gjuhën standarde, në funksion të qartësisë së koncepteve shkencore;
- të japë detaje të mjaftueshme për të realizuar kuptimin e saktë.

Treguesit dhe kompetencat e avancuara/opsionalë në kontekste specifike

Kompetencat dhe treguesit e përcaktuar më parë si të avancuara/opsionale nuk përfshihen në kornizën e kompetencave themelore. Formulime të tilla konceptualisht janë të papajtueshme me përkufizimin e kompetencave që duhet të zotërojnë mamitë.

KATEGORIA 1

KOMPETENCAT E PËRGJITHSHME

KOMPETENCAT E

PËRGJITHSHME

Në këtë kategori Kompetencat kanë në vëmendje:

-maminë si anëtare e stafit të kujdesit shëndetsor;

-lidhjen midis gruas dhe personelit që kujdeset për të;

-aktivitetet që përfshijnë aspektet praktike të punës së mamisë.



1.a Marr përgjegjësi për vendimet dhe veprimet e mia si profesionist i pavarur

NJOHURITË:

- Parimet e përgjegjësisë dhe transparencës;
- Parimet dhe konceptet e pavarësisë;
- Parimet e vetëvlerësimit dhe praktikës reflektive;
- Siguria personale dhe ndikimi i saj në praktikë;
- Njohuritë dhe praktikat e bazuara në protokolle.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Trego sjellje që sigurojnë besimin e shoqërisë në këtë profesion.
- Merr pjesë në vetëvlerësimin, vlerësimin e kolegëve dhe në aktivitete të tjera për përmirësimin e cilësisë së shërbimit.
- Barazpesho përgjegjësitë e mamisë në kujdesin ndaj nënës me pavarësinë e gruas për të marrë vendime.
- Shpjego rolin e mamisë në dhënien e kujdesit ndaj gruas e fëmijës, në përputhje ligjshmërinë, etikën profesionale dhe protokollët institucionalë.

1.b Marr përgjegjësi për kujdesin ndaj vetes dhe kualifikimin profesional si mami

NJOHURITË:

- Strategjitë për të menaxhuar sigurinë personale brenda institucionit ose njësisë komunitare.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Shpalos aftësitë vetjake në menaxhimin e kohës, pasigurisë, ndryshimit dhe stresit.
- Merr përgjegjësi për sigurinë personale në mjedise të ndryshme pune.
- Siguro aftësi dhe njohuri të përditësuara për protokollin, udhëzimet dhe sigurinë në punë.
- Kualifikohu profesionalisht duke u bërë pjesë e edukimit profesional në vijimësi (p.sh.: aplikimi i protokolleve në praktikë, përmirësimi i kujdesit ndaj pacientit, ulja e raporteve të mortalitetit, njohja e zhvillimi i politikave, etj).
- Identifiko dhe adresoj kufizimet në aftësitë profesionale, njohuritë dhe përvojën.
- Promovo profesionin e mamisë duke u përfshirë në organizata profesionale në nivel lokal dhe kombëtar.

1.c Respekto protokollin e kujdesit ndaj pacientit dhe siguro mbikqyrjen

NJOHURITË

- Njohja e politikave dhe rregulloreve për kujdesin ndaj pacientit.
- Përdorimi i strategjive mbështetëse në mbikqyrjen e të tjerëve.
- Njohja e rolit të mamive si perceptuese, mentore dhe modele profesioniste.

AFTESITË DHE SJELLJET

- Mbikqyr për t'u siguruar që praktika individuale i përshtatet udhëzimeve protokollare në praktikën klinike.
- Vetëkualifikohu përmes pjesëmarrjes në trajnimet profesionale mbi:
 - shërbimin e mamive;
 - përsosjen e roleve dhe perceptuesve klinikë;
 - mentorimin dhe rolin udhëheqës.

1.d Përdor kërkimin shkencor për të përsosur praktikën

NJOHURITË

- Njohja e parimeve të kërkimit dhe praktikës së bazuar tek protokollet.
- Aplikimi i koncepteve epidemiologjike që lidhen me shëndetin e nënës dhe fëmijës.

AFTESITË DHE SJELLJET

- Diskuto gjetjet e kërkimeve shkencore me gratë dhe kolegët.
- Mbështet kërkimet shkencore në specialitetin e mamisë duke marrë pjesë në udhëheqjen e tyre.

1.e Ruaj të drejtat themelore të njeriut kur ushtron profesionin e mamisë

NJOHURITË

- Ligjet dhe/ose kodet që mbrojnë të drejtat e njeriut.
- Të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues për vajzat dhe gratë.
- Zhvillimi i identitetit gjinor dhe orientimit seksual.
- Parimet e etikës dhe të drejtat e njeriut brenda praktikës së mamisë.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Informo gratë rreth të drejtave të tyre shëndetsore seksuale dhe riprodhuese.
- Informo gratë për hapsirën e punës së mamisë si dhe për të drejtat dhe detyrat e grave.
- Jep informacion dhe mbështetje për personat në situata të ndërlikuara, të cilat rrezikojnë parimet dhe të drejtat etike.
- Puno në përputhje me filozofinë dhe kodet e etikës të KNM-së dhe standarteve kombëtare për punonjësit e shëndetësisë.
- Transmeto kujdes gjinor me ndjeshmëri të lartë.



1.f Përmbaju ligjshmërisë, kërkesave protokollare dhe kodeve të punës në praktikën e mamisë

NJOHURITË

- Shpjegim i ligjeve dhe protokolleve juridike në lidhje me standardet kombëtare/shtetërore/lokale për praktikën e mamisë.
- Parimet etike.
- Filozofitë, vlerat dhe kodet e etikës për mamitë të formuluar nga KNM ose institucione të tjera.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Puno sipas kërkesave ligjore dhe parimeve të etikës.
- Përmbush kërkesat e mirëmbajtjes së regjistrimit të mamive.
- Ruaj konfidencialitetin e informacionit gojor dhe dokumentave të shkruara rreth kujdesit për gruan dhe fëmijën.
- Mbjaj dokumentacionin e shërbimit në mënyrën e kërkuar nga autoritetet e shëndetësisë.
- Zbato rregullat e raportimit për regjistrimet e lindjeve dhe vdekjeve.
- Zbulo thyerjen e ligjit, të rregulloreve dhe kodeve të etikës dhe ndërmer veprimet e duhura.
- Raporto dhe dokumento sipas protokollit, incidentet dhe rezultatet e pavlefshme.

1.g Ndhimo gratë të zgjedhin shërbimet e duhura

NJOHURITË

- Normat dhe praktikat kulturore që lidhen me seksualitetin, praktikat seksuale, martesën, shtatzaninë dhe prindërimin.
- Parimet e fuqizimit.
- Metodot e dhënies së informacionit shëndetsor tek individët, grupet, komunitetet.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Nxit dhe mbështet gratë që të jenë vendimmarrëset kryesore për kujdesin ndaj vetes.
- Asisto gratë të identifikojnë nevojat, njohuritë, aftësitë dhe parapëlqimet përgjatë gjithë kohës së shtatzanisë.
- Siguro informacione dhe udhëzime paraprake për shëndetin seksual dhe riprodhues, për të ndihmuar gratë në vendimmarrje.
- Bashkëpunu me gratë në hartimin e një plani gjithpërfshirës, i cili respekton parapëlqimet dhe vendimet e tyre.

1. h Demonstru komunikim ndërpersonal efektiv me gratë dhe familjet, ekipet e shërbimit shëndetsor dhe grupet komunitare

NJOHURITË

- Roli dhe përgjegjësitë e mamive dhe personelit përkatës për shëndetin e nënës dhe fëmijës.
- Parimet e komunikimit efektiv.
- Parimet e punës efektive në ekipet e kujdesit shëndetsor.
- Praktikrat dhe besimet kulturore lidhur me shtatzaninë dhe shëndetin riprodhues.
- Parimet e komunikimit në situata krize, p.sh.humbje dhe pikëllim, urgjenca.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Dëgjo të tjerët në mënyrë të drejtë dhe empatike.
- Respekto pikëpamjet e të tjerëve.
- Nxit dhe promovoj shprehjen e perspektivave dhe opinioneve të ndryshme.
- Përdor gjuhën e parapëlqyer nga gruaja apo nga përkthyesi për të maksimalizuar komunikimin.
- Vendos kufijtë e duhur etikë dhe kulturorë në marrëdhëniet midis profesionistit dhe joprofesionistit.
- Demonstru ndjeshmëri kulturore për gruan, familjen, komunitetin.
- Demonstru ndjeshmëri dhe empati për gratë e pikëlluara dhe anëtarët e familjes.
- Lehtëso punën në grup dhe kujdesin ndërprofesional me punonjësit e tjerë të shëndetësisë (përfshire studentët) dhe grupet komunitare/agjensitë.
- Vendos dhe mbaj marrëdhënie bashkëpunimi me individët, agjensitë, institucionet që janë pjesë e network-eve të referencës.
- Jep informacion saktësisht të qartë dhe përgjigju nevojave të individëve.



1.i Lehtëso proceset e lindjes normale në mjedise institucionale dhe komunitare përfshirë edhe shtëpitë e nënave

NJOHURITË

- Aspektet normale biologjike, psikologjike, sociale dhe kulturore të riprodhimit dhe fillimit të jetës.
- Praktikrat që lehtësojnë dhe ato që ndërhyjnë në proceset normale.
- Politikrat dhe protokollet rreth kujdesit për gratë në mjedise institucionale dhe komunitare.
- Gadishmëria e burimeve në mjedise të ndryshme.
- Pikëpamjet e komunitetit rreth përdorimit të njësive të kujdesit shëndetsor si dhe vendeve të lindjes.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Promovo politika dhe kulturë pune që vlerësojnë proceset normale të lindjes.
- Përdor burimet e kujdesit njerëzore dhe klinik për të siguruar kujdes të personalizuar për gruan dhe fëmijën.
- Siguro vijimësinë e kujdesit shëndetsor me mami që e njohin gruan.

1.j Vlerëso gjendjen shëndetsore, analizo rreziqet shëndetsore, promovoj shëndetin e përgjithshëm dhe mirëqënien për nënën dhe fëmijën

NJOHURITË

- Nevojat shëndetsore që lidhen me riprodhimin.
- Gjëndjet shëndetsore që paraqesin rrezik gjatë riprodhimit.
- Nevojat shëndetsore të fëmijëve dhe rreziqet e zakonshme.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Bëj vlerësim të kujdesit për të kuptuar nevojat e shëndetit seksual dhe riprodhues.
- Vlerëso faktorët e rrezikut dhe sjelljet që paraqesin rrezik.
- Porosit, kryej dhe interpreto testet laboratorike dhe imazherike.
- Shpreh mendimin kritik dhe arsyetimin klinik të mbështetur tek protokollet të cilat promovojnë shëndetin dhe mirëqënien.
- Jep informacion shëndetsor dhe këshilla në përshtatje me rrethanat individuale të grave dhe familjeve të tyre.
- Bashkëpunoj me gratë për hartimin dhe interpretimin e planit të shërbimit mjekësor.

1.k Parandalo dhe trajto problemet e zakonshme shëndetsore që lidhen me riprodhimin dhe fillimet e jetës

NJOHURITË

- Problemet e zakonshme shëndetsore që lidhen me seksualitetin dhe riprodhimin.
- Problemet e zakonshme shëndetsore dhe devijimet shëndetsore të fëmijëve të porsalindur.
- Trajtimi i problemeve të zakonshme shëndetsore.
- Strategjitë për parandalimin, kontrollin, marrjen dhe transmetimin e sëmundjeve të transmetueshme mjedisore.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Ruaj/promovoj kushte të sigurta higjienike për gratë dhe fëmijët.
- Përdor masa paraprake universale në mënyrë të vazhdueshme.
- Ofroju grave mundësi për përballimin dhe trajtimin e problemeve të zakonshme të shëndetit.
- Përdor teknologjinë dhe ndërhyrjet në mënyrë të përshtatshme, për të promovuar shëndetin dhe parandaluar komplikacionet dytësore.
- Përcakto se kur konsulta ose referenca duhet të bëhet për menaxhimin e problemeve të identifikuar, përfshirë edhe konsultën me mami të tjera.
- Përfshi gratë në vendimmarrje rreth referimit të tjerë përfaqësues të ekipeve shëndetsore.



1.1 Zotëro kushtet jashtë fushës së praktikës së mamive dhe referoju atyre në mënyrën e duhur

NJOHURITË

- Komplikacionet/gjendjet patologjike që lidhen me statusin shëndetsor.
- Kufijtë e fushës së praktikës së mamive dhe përvojën vetjake.
- Sisteme të gatshme referimi mbi menaxhimin e komplikacioneve, për të qenë i denjë si pjesëmarrës në personelin mjeksorë.
- Planet e komunitetit/njesisë dhe protokollet për qasjen në burime brenda kohës së duhur.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Siguro aftësi, mjete dhe njohuri të përditësuara për t'u përgjigjur në situata emergjente.
- Veço situatat që kërkojnë ekspertizë përtej kujdesit të mamisë.
- Komunikoj me gratë rreth natyrës së problemit, veprimeve të ndërmarra dhe referimeve nëse është e nevojshme.
- Përcakto nevojat për ndërhyrje të menjëherëshme dhe reago në mënyrë të përshtatshme.
- Implemento ndërhyrje të përshtatshme në kohë, konsulta ndërpersonale dhe/ose referim në kohë duke mbajtur parasysh rrethanat lokale.
- Jep informacion të saktë me gojë dhe shkrim tek dhënësit e tjerë të kujdesit kur bëhet referimi tek ta.
- Bashkëpunoj me vendimmarrësit nëse është e mundur dhe e përshtatshme.



1.m Kujdesu për gratë që përballen me dhunën dhe abuzimin fizik dhe seksual

NJOHURITË

- Kushtet social-kulturore, ekonomike dhe sjelljet që shoqërojnë shpesh dhunën.
- Burimet e komunitetit që mund të ndihmojnë gratë dhe fëmijët.
- Rreziqet për zbulim.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Ruaj privatësinë dhe konfidencialitetin.
- Jepu informacion të gjitha grave për burimet e ndihmës, pavarësisht se mund të zbulohet dhuna.
- Kërkoju informacione mbi sigurinë në shtëpi, punë.
- Mësohu të njohësh shenjat e mundshme të abuzimit nga pamja fizike, gjendja emocionale dhe ato që lidhen me sjellje të rrezikshme, si abuzimi me substancat.
- Siguro mbështetje të specializuar për adoleshentët dhe viktimat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë përdhunimin.
- Referohu tek burimet e komunitetit, ndihmo në gjetjen e mjediseve të sigurta nëse nevojitet.

KATEGORIA 2

PARA SHTATZANISË DHE PARALINDJES

Në këtë kategori kompetencat lidhen me:

- vlerësimin shëndetsor të gruas dhe të fetusit;
- promovimin e mirëqënies;
- zbulimin e komplikacioneve gjatë shtatzanisë;
- kujdesin për gruan me shtatzani të padëshiruar.



2.a Ofro shërbim para shtatzanisë

NJOHURITË

- Anatomia dhe fiziologjia e femrës dhe mashkullit e lidhur me riprodhimin dhe zhvillimin seksual.
- Aspektet socio-kulturore të seksualitetit njerëzor. Analiza të bazuara tek studimet mbi kancerin e organeve riprodhuese dhe problemeve të tjera shëndetsore si diabeti, hipertensioni, teroidet dhe infeksionet kronike që ndikojnë tek shtatzania.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Identifiko dhe ndihmo në reduktimin e barrierave në lidhje me arritjen dhe përdorimin e shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues.
- Vlerëso gjendjen e ushqyerjes, imunitetit, sjelljeve shëndetsore si duhanpirja, kushtet egzistuese mjekësore dhe ekspozimin ndaj tratogjenëve të njohur.
- Kryej procedurat për egzaminimin e SST-ve dhe infeksioneve të tjera, HIV, kanceri cervikal.
- Jep këshilla rreth suplementeve ushqimorë si acidi folik, dieta, ushtrimet fizike, përditësimin e imunitetit sipas nevojës, modifikimin e sjelljeve me rrezik dhe parandalimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme.

2.b Përcakto gjendjen shëndetsore të gruas

NJOHURITË

- Fiziologjia a ciklit menstrual dhe ovarian.
- Komponentet e historisë shëndetsore përfshirë reagimet psiko-sociale ndaj shtatzanisë dhe sigurisë në shtëpi.
- Komponentet e ekzaminimit të plotë fizik.
- Gjendja shëndetsore përfshirë infeksionet dhe gjendjen gjenetike të zbuluar nga kampionet e gjakut dhe ato biologjike.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Konfirmo shtatzaninë dhe vlerëso moshën xhestacionale nga historia, ekzaminimi fizik, testet laboratorike dhe/ose me ultratinguj.
- Mundohu të kuptosh sa më mirë historinë shëndetsore të pacientes.
- Bëj një ekzaminim të plotë fizik.
- Siguro kampione biologjike për analiza laboratorike (psh. venipunkturë, gishtpunkturë, kampione urine dhe tamponë vaginalë).
- Siguro informacion rreth gjëndjes shëndetsore që mund të dallohet nga imazheria.
- Vlerëso statusin imunologjik dhe përditësoje konform rregullave.
- Diskuto me gruan gjetjet e implikimet e mundshme dhe së bashku vendosni planin e kujdesit shëndetsor.

2.c Vlerëso mirëqënien e fetusit

NJOHURITË

- Fiziologjia e placentës, embriologjia, rritja dhe zhvillimi i fetusit dhe indikatorët e mirëqënies së fetusit.
- Udhëzimet e mbështetura tek protokollet për përdorimin e ultratingullit.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Vlerëso masën e fetusit, vëllimin e lëngut amniotik, pozicionin e fetusit, aktivitetin dhe ritmin e zemrës nga ekzaminimi i barkut te nënës.
- Pëcakto nëse ka tregues për vlerësime/ekzaminime shtesë dhe kryeji siç duhet.
- Vlerëso lëvizjet e fetusit dhe pyet gruan për këto lëvizje.

2.d Monitoro zhvillimin e shtatzanisë

NJOHURITË

- Ndryshimet e zakonshme fiziologjike dhe fizike me përparimin e shtatzanisë.
- Kërkesat e ushqyerjes në shtatzani.
- Reagimet e zakonshme fiziologjike në shtatzani dhe simptomat e distresit psikologjik.
- Udhëzimet dhe politikat pas lindjes të mbështetura tek protokollet, përfshirë edhe shpeshësinë e vizitave para lindjes.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Bëj vlerësime për gjëndjen fizike dhe psikologjike të gruas përgjatë gjithë shtatzanisë, lidhjet familjare dhe nevojat për edukim shëndetsor.
- Jep informacion rreth shtatzanisë normale tek gruaja, partneri i saj, anëtarët e familjes dhe persona të tjerë mbështetës.
- Sugjero masa për përballimin e problemeve normale të shtatzanisë.
- Jep informacion (të shkruar ose me ilustrime) rreth shenjave të rrezikut (gjakrrjedhje vaginale, shenja të lindjes së parakohëshme, çarje të membranave), rreth përgatitjeve për emergjencat dhe burimeve të ndihmës.
- Ndërsa shtatzania përparon, rishiko së bashku me gruan gjetjet dhe planin e shërbimit.

2.e Promovo dhe mbështet sjelljet shëndetsore që sigurojnë mirëqënien

NJOHURITË

- Impakti i efekteve të dëmshme të kushteve sociale, mjedisore dhe ekonomike në shëndetin e nënës dhe fetusit.
- Efektet e kequshqyerjes dhe punës së rëndë fizike.
- Efektet e duhanpirjes, ekspozimit ndaj tymit të duhanit, përdorimit të alkoolit dhe drogave të varësisë.
- Efektet e ilaçeve me recetë tek fetusit.
- Burimet komunitare për mbështetjen me të ardhura, ushqime dhe programet për minimizimin e rreziqeve të abuzimit me substancat.
- Strategjitë për të parandaluar ose reduktuar rreziqet e transmetimit të sëmundjeve nga nëna tek fëmija, përfshirë mundësitë e ushqyerjes së fëmijës në rastet e infeksionit HIV.
- Efektet e dhunës me bazë gjinore, abuzimit emocional dhe braktisjes fizike.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Jepu grave mbështetje emocionale për të inkurajuar ndryshimin e sjelljeve shëndetsore.
- Jepi informacion gruas dhe familjes rreth impaktit të kushteve të rrezikshme mbi nënën dhe fetusin.
- Këshillo dhe refero gratë tek personat ose agjensitë e duhura të asistencës dhe trajtimit.
- Respekto vendimet e gruas rreth pjesëmarrjes në programet e trajtimit.
- Rekomando dhe identifikoj burimet për reduktimin/lënien e duhanpirjes në shtatzani.



2.f Jep udhëzime paraprake në lidhje me shtatzaninë, lindjen, ushqyerjen me gji, prindërimin dhe ndryshimet në familje

NJOHURITË

- Nevojat e individëve dhe familjeve për informacione të ndryshme në kohë të ndryshme të cikleve jetësore respektive.
- Metodat e dhënies së informacionit tek individët dhe grupet.
- Metodat e zbulimit të ndjenjave të nënës dhe pritshmëritë e saj për veten, fëmijën dhe familjen.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Merr pjesë dhe refero gruan tek programet formuese për lindjen e fëmijës.
- Jep informacion në mënyrë të qartë, të saktë dhe përgjigju nevojave të individëve.
- Përgatit gruan, partnerin dhe familjen në mënyrë që:
 - të njohin dhimbjet e paralindjes;
 - të dinë ku të kërkojë asistencë
 - të njohin përparimin e shtërzimeve.
- Jep informacion për nevojat postpartum përfshirë kontracepsionin, kujdesin për të sapolindurin dhe rëndësinë e ushqyerjes me gji për shëndetin e fëmijës.
- Identifiko nevojat ose problemet që kërkojnë ekspertizë ose referencë të avancuar, si frika e madhe ose marrëdhëniet jofunksionale.

2.g Zbullo, menaxho dhe refero gratë me shtatzani të komplikuar

NJOHURITË

- Komplikacionet e hershme të shtatzanisë si rreziku për abort, aborti spontan dhe shtatzania ektopike.
- Rrezikimi i fetusit, pengimi i rritjes, keqpozicionimi, shtërzimet e parakohëshme.
- Shënjat dhe simptomat e gjendjeve patologjike të nënës si pre-eclampsia, diabeti xhestacional, dhe sëmundje të tjera kronike.
- Shënjat e emergjencave akute si hemorragjia, krizat dhe sepsis.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Ji profesioniste në shërbimin shëndetsor ose referimin për trajtimin e komplikacioneve.
- Ndërmerr veprime të kujdesit kritik për të mbështetur funksionet vitale të trupit (lëngje intravenoze).
- Mobilizo dhuruesit e gjakut nëse është e domosdoshme.
- Transfero gruan në institucione të nivelit të lartë nëse nevojitet.

2.h Asisto gruan dhe familjen e saj për të gjetur vendin më të përshtatshëm për lindje

NJOHURITË

- Evidenca për rezultatet e lindjes në mjedise të ndryshme lindjeje.
- Mundësitë e mjediseve specifike; kufizimet e klimës, gjeografisë, mjeteve të transportit, dhe burimet tek njësitë shëndetsore.
- Udhëzimet dhe politikat lokale.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Diskuto mundësitë, parapëlqimet dhe planet egzistuese me gruan dhe personat mbështetës duke respektuar vendimet e tyre.
- Jep informacion rreth përgatitjes së vendit të lindjes në komunitet, psh. udhëtimin dhe pranimin në njësinë shëndetsore.
- Promovo shumëllojshmërinë e vendeve të lindjes.



2.i Jep kujdes për gratë me shtatzani të padëshiruar dhe në kohë jo të përshtatshme

NJOHURITË

- Komplikimet në vendimmarrje për shtatzanitë e padëshiruara dhe ato të papërshtatshme në kohë.
- Kontracepsioni i emergjencës
- Opsionet ligjore për abortin e detyruar; pranimi dhe mundësia e abortit kirurgjikal.
- Mjekimet që përdoren për të provokuar abortin: vetitë, përfundimet dhe efektet anësore.
- Rreziqet e abortit të pasigurt.
- Metodot e duhura të planifikimit familjar në periudhën pas abortit.
- Kujdesi dhe mbështetja (fizike dhe psikologjike) që nevojitet gjatë dhe pas abortit.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Konfirmo shtatzaninë dhe përcakto moshën xhestacionale; rrefero gruan për ECO në rast xhestacioni të panjohur dhe/ose për simptoma të shtatzanisë ektopike.
- Këshillo gruan rreth mundësive të mbajtjes ose ndërprerjes së shtatzanisë dhe respekto vendimin përfundimtar të saj.
- Siguro kujdes mbështetës antenatal nëse shtatzania vazhdon; referoju agjensive dhe shërbimeve sociale për mbështetje dhe asistencë kur është e nevojshme.
- Identifiko historinë obstetrike, mjeksore dhe sociale, kundërindikacionet nga mjekimet ose mënyrat e aspirimit.
- Jep informacion rreth rregullatorëve ligjorë, pranimin dhe përdorimin e shërbimeve të abortit.
- Jep informacion rreth procedurave të abortit, komplikacioneve të mundshme, menaxhimin e dhimbjeve dhe kohën e ndërhyrjes për ndihmë.
- Referoju shërbimeve të abortit vetëm me kërkesë.
- Ofro shërbim pas abortit:
 - konfirmo mospërdorimin e produkteve të konceptionit, ECO-ja dhe niveli i HCG-së;
 - rishiko mundësitë e kontracepsionit dhe nis përdorimin e menjëhershëm të metodës;
 - zbulo reagimet psikologjike ndaj abortit.



KATEGORIA 3

KUJDESI PARA DHE GJATË LINDJES

Në këtë kategori kompetencat fokusojnë:


-vlerësimin dhe kujdesin për gruan

gjatë dhe para lindjes;

-lehtësimin e proceseve fiziologjike për një lindje të sigurtë;

-kujdesin e menjëhershëm për të porsalindurin;

- zbulimin e komplikacioneve të mundshme te nëna ose fëmija.



3.a Promovimi i shtërzimeve dhe lindjes fiziologjike

NJOHURITË

- Anatomia e legenit të nënës dhe fetusit; mekanizmat e shtërzimeve për fetuse të ndryshëm.
- Fiziologjia dhe vazhdimësia e shtërzimeve.
- Evidenca rreth ndërhyrjeve gjatë shtërzimeve dhe lindjes normale.
- Besimet social-kulturore dhe traditat rreth lindjes.
- Shenjat dhe sjelljet gjatë shtërzimeve; faktorët që ndikojnë në vazhdimësinë e shtërzimeve.
- Metodat e vlerësimit të fetusit gjatë shtërzimeve.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Kujdesu për gruan në vendin që ajo ka zgjedhur për lindje duke ndjekur politikat dhe protokollet.
- Mbaj parasysh historinë obstetrike dhe mjeksore.
- Kryej dhe interpreto ekzaminimin fizik të gruas dhe fetusit
- Porosit dhe interpreto testet laboratorike nëse është e domosdoshme.
- Vlerëso reagimet fizike dhe sjelljet e gruas gjatë shtërzimeve.
- Jepi informacion, mbështetje dhe inkurajim gruas gjatë procesit të shtërzimeve dhe lindjes.
- Ofro ndihmë profesionale duke treguar respekt.
- Inkurajo lirshmërinë e lëvizjeve dhe pozicionet më këmbë.
- Siguro ushqim dhe lëngje.
- Ofro ndihmë dhe mbështetje gruan duke përdorur strategjitë e përballimit të dhimbjeve e të shtërzimeve si kontrolli i frymëmarrjes, zhytja në ujë, relaksimi, masazhi dhe modalitetet farmakologjike kur lind nevoja.
- Vlerëso rregullisht parametrat e gjendjes nënë-fetus, si shenjat vitale, kontraktimet, ndryshimet e legenit dhe zbritjen e fetusit.
- Përdor grafikun progresiv të shtërzimeve duke reflektuar të dhënat dhe asisto në zbulimin e vonesave të shtërzimeve apo komplikacioneve eventuale.
- Ul kontraktimet uterine, duke vendosur profesionalisht mbi përdorimin e agjentëve jofarmakologjike dhe atyre farmakologjike për parandalimin e shtërzimeve regresive.
- Parandalo ndërhyrjet e panevojshme rutinë si amniotominë, monitorimin elektronik të fetusit, shtyrjen e drejtuar të glotisit të mbyllur.

3.b Modero një lindje spontane vaginale dhe parandalo komplikacionet

NJOHURITË

- Metodot e administrimit të lindjes duke ruajtur integritetin perineal.
- Protokolle për administrimin e fazës së tretë, përfshirë përdorimin e uterotonikëve.
- Komplikacionet e mundshme dhe trajtimi i tyre i menjëhershëm, p.sh. distokia e shpatullës dhe hemorragjia e pandëroprerë.
- Shënjat e ndarjes së placentës; pamja e placentës normale, membranat dhe kordoni umbilikal.
- Tipat e traumave perineale dhe vaginale që kërkojnë riparim; teknikat e qepjes.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Mbështet gruan të lindë në pozicionin që ajo vetë ka zgjedhur.
- Siguro pajisje të pastra të domosdoshme dhe ngrohje të mjedisit.
- Trajnoj gruan si të shtyjë për të kontrolluar largimin e pjesëve të dukshme; shmang episiotominë rutinë.
- Kryej manovrimet e përshtatshme dhe përdor pozicionet materne për të lehtësuar lindjen me kokë, me fytyrë dhe me të ndenjura.
- Bëj lidhjen e kordonit.
- Menaxho kordonin e lidhur rreth qafës.
- Vlerëso menjëherë gjendjen e të porsalindurit.
- Krijoj kontaktin trup me trup nënë-foshnje në një mjedis me ngrohje.
- Merr placentën dhe membranat dhe kontrollo nëse janë të kompletuara.
- Vlerëso tonusin e uterusit, ruaj tkurrjen e fortë, vlerëso dhe regjistro humbjen e gjakut nga nëna.
- Kontrollo zonën vaginale dhe perineale për trauma; bëj riparimet e nevojshme sipas praktikave dhe protokolleve.

3.c Kujdesu për të porsalindurin menjëherë pas lindjes

NJOHURITË

- Tranzicioni normal në mjedisin ekstra-uterin.
- Sistemet me pikëzim për vlerësimin e gjendjes së të porsalindurit.
- Shënjat që tregojnë domosdoshmërinë e veprimeve të menjëhershme për të ndihmuar tranzicionin.
- Pamja dhe sjellja e të porsalindurit të shëndetshëm
- Metodot për vlerësimin e moshës xhestacionale të të porsalindurit
- Ndhimat e para për moshën xhestacionale dhe për të porsalindurin nën peshë.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Përdor metodat standarde për të vlerësuar gjendjen e të porsalindurit që në minutat e para të jetës (Apgar ose të tjera); referoje nëse duhet.
- Ndërmerr veprime për të mbështetur frymëmarrjen dhe oksigjenimin.
- Krijoj mjedis të sigurt dhe të ngrohtë për fillimin e ushqyerjes me gjë si dhe lidhjen me nënën që në orën e parë të jetës.
- Kryej ekzaminim të plotë fizik të të porsalindurit në prani të nënës/familjes, shpjego gjetjet dhe ndryshimet e pritshme (p.sh. ngjyrën e ekstremiteteve, modelimin e formës së kokës). Refero fëmijën me problematika anormaliteti.
- Bëj profilaksinë e të porsalindurit, p.sh. infeksione të veshit apo sëmundje hemorragjike, sipas praktikave dhe udhëzimeve.
- Promovo kujdesin nga nëna, ushqyerjen e vazhdueshme dhe vëzhgimin nga afër.
- Përfshij partnerin/mbështetësit në kujdesin për të porsalindurin.



KATEGORIA 4

KUJDESI I VAZHDESHËM PËR GRATË DHE TË PORSALINDURIT

Kompetencat në këtë kategori adresojnë:

- vlerësimin shëndetsor të vazhdueshëm të nënës dhe fëmijës;
- edukimin shëndetsor të nënës;
- asistencën për ushqyerjen me gji të fëmijës;
- zbulimin e komplikacioneve;
- dhënien e shërbimit mbi planifikimin familjar.



4.a Dhënia e kujdesit paslindjes për gruan e shëndetshme

NJOHURITË

- Ndryshimet fiziologjike që pasojnë lindjen, ndërlikimet uterine, fillimi i laktacionit, shërimi i indeve perineale –vaginale.
- Problematikat e zakonshme shëndetsore të paslindjes dhe masat për administrimin e tyre.
- Nevoja për çlodhje, mbështetje dhe ushqim në ndihmë të laktacionit.
- Reagimet psikologjike të nënës së re, lidhja e fëmijës me familjen.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Rishiko historinë e shtatzanisë, shtëzimeve dhe lindjes.
- Kryej një ekzaminim fizik për ndryshimin e gjinjve dhe ndërlikimeve. Monitoro humbjen e gjakut dhe funksionet e tjera të trupit.
- Vlerëso humorin dhe ndjenjat rreth mëmësisë si dhe kërkesat për kujdesin ndaj fëmijës.
- Zbato strategjitë e kontrollit të dhjimbjes për kontraksionet uterine dhe traumat perineale.
- Jep informacion rreth kujdesit vetjak që e lejon nënën të kujdeset për fëmijën si: ushqimi i duhur, suplementet ushqimore, aktivitetet e zakonshme, periudhat e pushimit dhe ndihma në punët e shtëpisë.
- Jep informacion rreth seksit të sigurt, metodave të planifikimit familjar, të përshtatshme menjëherë pas lindjes si dhe për kohën që duhet të kalojë deri në shtatzaninë e rradhës.

4.b Dhënia e kujdesit për të porsalindurin e shëndetshëm

NJOHURITË

- Pamja dhe sjellja e fëmijës në fillim të jetës; ndryshimet kardio-respiratore të lidhura me adaptimet me jetën ekstra-uterine.
- Rritja dhe zhvillimi në javët dhe muajt e parë të jetës.
- Protokollet për egzaminimin e gjendjes metabolike, infeksioneve dhe anomalive kongenitale.
- Protokollet/udhëzimet për imunizimin në fëmijëri.
- Informacioni i mbështetur tek evidencat për rrethprerjen e fëmijës; vlerat e familjes; besimet dhe normat kulturore.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Ekzamino fëmijën në intervale të rregullta për të monitoruar rritjen dhe sjelljet që tregojnë zhvillim.
- Dallo ndryshimet normale në pamjen dhe sjelljen e të porsalindurit, nga ato që tregojnë patologji të ndryshme.
- Administro imunizimin, bëj analiza të ndryshme kur nevojitet.
- Jep informacion tek prindërit rreth mjedisit të sigurt për fëmijën, ushqyerjen e vazhdueshme, kujdesin për kordonin umbilikal, urinimin dhe defekimin dhe kontaktin e afërt fizik.

4.c Promovo dhe mbështet ushqyerjen e foshnjës me gji

NJOHURITË

- Fiziologjia e laktacionit.
- Nevojat ushqimore të fëmijëve të porsalindur, përfshirë dhe fëmijët nën peshë.
- Aspektet sociale, psikologjike dhe kulturore të ushqyerjes me gji.
- Materiale studimore rreth përfitimeve të ushqyerjes me gji.
- Dëmet e shkaktuara nga përdorimi i drogës dhe substancave narkotike gjatë ushqyerjes me gji.
- Ndërgjegjësimi mbi ndihmesën e të ushqyerit me gji.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Promovo ushqyerjen e hershme të fëmijës me gji (UMGJ), ndërkohë që respekton zgjedhjet e gruas për mënyrën e ushqyerjes së të porsalindurit.
- Jep informacion rreth nevojave të fëmijës, shpeshësisë dhe kohëzgjatjes së ushqyerjes dhe shtimit në peshë.
- Jep mbështetje dhe informacione për UMGJ-në për së paku gjashtë muaj, ndërthurjen e saj me punën, mirëmbajtjen e sasisë së qumështit dhe mënyrën e ruajtjes të qumështit të gjirit.
- Identifiko dhe menaxho problemet e UMGJ-së (psh. mastitin, sasinë e pakët të qumështit, bllokimin e gjirit, kapjen e gabuar të gjirit nga fëmija).
- Jep informacione për UMGJ-në në rastin e lindjes së shumëfishtë.
- Drejtoje gruan tek mbështetësit e UMGJ-së
- Propagando UMGJ-në në familje dhe në komunitet.

4.d Zbulo dhe trajto ose refero komplikacionet pas lindjes tek gruaja

NJOHURITË

- Njohuritë mbi shenjat dhe simptomat e:
 - gjendjeve të ndryshme pas lindjes që kërkojnë ndërhyrje të hershme (psh. nënndërlikime, anemia dhe retensioni urinar)
 - komplikacioneve që kërkojnë trajtime ose referime në institucione të specializuara (psh. hematoma, thrombophlebitis, sepsis, obstetric fistula, dhe incontinenca)
 - komplikacioneve mortale që kërkojnë reagim të menjëhershëm dhe kujdes të specializuar (hemorrhagji, amniotic fluid embolus, konvulsionet, dhe stroke).
- Shenjat dhe simptomat e depresionit, ankthit dhe psikozave të paslindjes.
- Procesi i pikëllimit që pason vdekjen periantale.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Informo gruan dhe familjen rreth komplikacioneve të mundshme dhe se kur duhet kërkuar ndihmë.
- Vlerëso gruan në periudhën e paslindjes për të dalluar shenja dhe simptoma të komplikacioneve.
- Dallo depresionin pas lindjes nga ankthi i përkohshëm për kujdesin ndaj bebes.
- Vlerëso mundësitë për ndihmë dhe mbështetje në shtëpi; jep mbështetje emocionale.
- Jep këshilla dhe kujdesu menjëherë për gruan dhe anëtarët e familjes që po përballen me lindjen e fëmijës së vdekur, me vdekjen e të porsalindurit, sëmundje serioze të fëmijës dhe gjëndje kongjenitale.
- Merr masa të vijës së parë për të trajtuar ose stabilizuar gjëndjet e identifikuara.
- Organizo referimin dhe/ose transferimin kur është e nevojshme.



4.e Zbullo dhe menaxho problemet shëndetsore të të porsalindurit

NJOHURITË

- Anomalitë kongjenitale dhe kushtet gjenetike.
- Nevojat e foshnjeve prematurë dhe atyre nën peshë.
- Simptomat dhe trajtimet për shkëputjen e nënës nga përdorimet e drogës.
- Parandalimi i kalimit të infeksioneve nga nëna tek fëmija si HIV, hepatiti B dhe C.
- Shenjat dhe simptomat e problemeve të zakonshme shëndetsore dhe trajtimi i tyre.

4.f Jep shërbime të planifikimit familiar

NJOHURITË

- Anatomia dhe fiziologjia e të dy gjinive lidhur me riprodhimin dhe zhvillimin seksual.
- Aspektet social-kulturore të seksualitetit njerëzor.
- Metodat e planifikimit familjar si: natyrale, me barrierë, hormonale, implantuese, kontracepsioni i urgjencës, sterilizimi, efektet e mundshme anësore, rreziku për shtatzani dhe kunderindikacionet.
- Burime të shkruara ose të ilustruara për mësimin e metodave të planifikimit familiar.
- Mundësitë për shtatzani në gratë ose çiftet me HIV.

AFTËSITË DHE SJELLJET

- Mbro privatësinë dhe konfidencialitetin e diskutimeve për njohuritë rreth metodave të planifikimit familjar, qëllimet për kufizimin e lindjeve dhe/ose shtyrjen në kohë të shtatzanive të njëpasnjëshme.
- Dokumento përdorimin e metodave, gjendjen mjeksore, vlerat socio-kulturore dhe preferencat që ndikojnë në zgjedhjen e metodës.
- Informo për mënyrën e përdorimit, efektivitetin dhe kostot e metodave të ndryshme për të ndihmuar vendimmartjen pas informimit të plotë.
- Shpjego metodat duke qëndruar brenda fushës së praktikës dhe protokolleve ose refero tek anëtarë të tjerë të ekipit shëndetsor.
- Trego mundësitë dhe vlerësimet e atyre që i kanë përdorur metodat, kënaqësinë që ata kanë marrë dhe efektet anësore.
- Fol me gruan apo partnerin e saj për procedurat e sterilizimit.

